



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 08-320/01-3884/23
Kaçanik, 27.02.2023

Në zbatim të nenit 12.22 (d), të Ligjit 03//L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës Kosovës Nr.28/ 4 Qershor 2008), të Vendimit të kuvendit Komunës Nr.01Nr.400/03-25102/22 të datës 29.09.2022- Për Miratimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2023 si dhe Rregullores Komunale Nr.06/2016, nenit 4 paragrafi 1 dhe 2, nenit 7 dhe nenit 8 pika 5, 7, 9 dhe nenit 19, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, për mbështetje të fermerëve, të Propozim Vendimi të Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari 08 Nr. 320/01-3884/23, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 27 shkurt 2023, mori këtë:

VENDIM

Për subvencionim të fermerëve

1. MIRATOHET Vendimi për mbështetje financiare për projektet si në vijim:

1.1 Lejohet subvencionimi në shumë prej katërdhjetë e katërmijë e katërqind euro (**44,400.00€**) nga pozicioni subvencione dhe transfere të DBZHRP-së si dhe 20% participim nga fermerët në shumë prej njëmbëdhjetëmijë e njëqind e euro (**11,100.00€**), për realizimin e projektit "Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor" (freza për tërheqje me traktor, moto kultivator me freza, kositëse me pjator për tërheqje me traktor), vlera e përgjithshme e projektit **55,500.00 €**.

1.2 Lejohen subvencionimi në shumë prej gjashtë mijë euro (**6,000.00€**) nga pozicioni subvencione dhe transfere të DBZHRP-së si dhe 20% participim nga fermerët në shumë prej njëmijë e pesëqind e euro (**1,500.00€**) për realizimin e projektit "Subvencionimi i fermerëve me makina mjelëse për lopë qumështore. vlera e përgjithshme e projektit **7,500.00€**.

1.3 Lejohen subvencionimi në shumë prej njëzet e tremijë e dyqind euro (**23,200.00€**) nga pozicioni subvencione dhe transfere të DBZHRP-së, për realizimin e projektit "Subvencionimi i fermerëve me mjete financiare, për mbjelljen e kulturës së grurit në sipërfaqe prej 0.40-1.0 ha.

1.4 Lejohen subvencionimi në shumë prej njëzet e gjashtëmijë katërqind euro (**26,400.00€**) nga pozicioni subvencione dhe transfere të DBZHRP-së, si dhe participimit të fermerëve në shumë prej gjashtë mijë e gjashtëqind euro (**6,600.00 €**), për realizimin e projektit subvencionimi i fermerëve me koshere bletësh dhe centrifuga elektrike për nxjerrjen e mjaltit, vlera e përgjithshme e projektit **33,000.00€**.

2. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, që në harmoni të Rregullores Komunale Nr.06/2016 , nenit 4 paragrafi 1 dhe 2, nenit 7 dhe nenit 8 pika 5, 7, 9 dhe nenit 19, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, në mbështetje të fermerëve, ti ndaj mjetet e cekura si në pikën 1 të këtij Vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria për Buxhet dhe Financa; Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Murseli





Data: 24.03.2023		
Lloji i aktit: KAÇANIK		
Nr. org.	Numri	Shtojcë
01	60/01-7355	-1.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministry of Local Government Administration	
Data	24.03.2023
Titulli	
Referencë	010-202/4

REPUBLIKA E KOSOVËS Qeveria e Kosovës / Vlada Kosovës / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministrstvo za Finansije Ministry of Finance Arhiva - Arhiva - Archive	
Nr. i aktit No. of the act No. of the act	409-1/2023
Data Date Date	24/03/2023
PRISHTINE/A	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Besim Hazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Fehmi Zena, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Bora Duli, Zyrtare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Hazi,
 I nderuari Kryesues z. Murseli

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe

Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendim Nr. 09-660/01-4005/23 për subvencionimin e OJQ-ve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Vendim Nr. 08-320/01-3884/23 për subvencionimin e fermerëve.

Të miratuara më datë 27.02.2023.

I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.03.2023

I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 02.03.2023

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), pas shqyrtimit përmbajtësor të akteve të mësipërme të Komunës së Kaçanikut, jep konstatime bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

1. Komuna e Kaçanikut, me anë të akteve administrative që janë subjekt i shqyrtimit, synon ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e OJQ-ve dhe fermerëve.
1. Edhe përkundër faktit se Komunave iu jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuara me nenin 2 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Komunitat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "**LMFPP**"), gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

Neni 7

Burimet Financiare Komunale

7.2 Komunitat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFPP gjatë disponimit me këto burime financiare.

2. Ajo që i faktorizon edhe më shumë detyrimet e përcaktuara me dispozitat e LMFPP-së është neni 81 i LMFPP-së, në të cilin precizohet që në rastet kur ky ligj ka mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, dispozitat e LMFPP-së kanë përparësi, sikurse përshkruhet më poshtë:

Neni 81

Hyrja në fuqi/Shfuqizimi i legjislacionit paraprak/Zbatueshmëria

81.1. Në rast mospërputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, që kanë të bëjnë me menaxhimin e parasë publike, dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të kenë përparësi, në pajtim edhe me nenin 36 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. [theks i shtuar]

3. Në rrjedhë të kësaj, LMFPK konsiderohet ligj organik që përcakton kushtet, procedurat dhe konditat ligjore për menaxhimin e mirëfilltë të financave publike në përgjithësi, dhe shpenzimin e parasë publike në veçanti.
4. Në kuptim të shpenzimit të rregullit të parasë publike, neni 17 i LMFPK-së precizon qartë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe të shpenzohen nga fondet e ndara dhe të alokuara [theks i shtuar].
5. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Kaçanikut, ku është evidentuar se organizata buxhetore i katë planifikuar shpenzimet e potencuara me aktin komunal për këtë vit fiskal.
6. Përkundër kësaj, për financimin publik të OJQ-ve, në gamën legjislative të Ministrisë evidentohen si relevante dispozitat ligjore të Rregullores Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve (këtej e tutje referuar si 'Rregullore për financimin e OJQ-ve'). Rrjedhimisht, dispozitat e kësaj Rregullore janë të zbatueshme dhe relevante për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal në këtë vit fiskal.
7. Ministria i rikujton Komunës se përgjatë zbatimit të vendimit dhe ndarjes së subvencioneve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit të zbatojë dispozitat ligjore të Rregullores Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
8. Si përfundim i këtij vlerësimi, aktet administrative të Komunës së Kaçanikut janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Data	08.03.23	Vendi	KAÇANIK
org.		Numri	
	01		400/01-5983

ZYRA E KRYETARIT

01-Nr. _____/23
Kaçanik: 08.03.2023

DATE:	
PËR/ZA/TO:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, MFPT Thesari i Republikës së Kosovës.
CC:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MFPT Thesari i Republikës së Kosovës.
NGA/OD/FROM:	z. Besim Ilazi – Kryetar i komunës Kaçanik.
PËRMES/PREKO/THROUGH	Gafurr Loku – Zyrtar Kryesor Financiar
TEMA / SUBJEKAT/ SUBJECT:	Përgjigjeje shtesë lidhur me Vendimin Nr.09-660/01-4005/23 për subvencionimin e OJQ-ve ne fushën e kulturës,rinisë dhe sportit dhe Vendimi Nr.08-320/01-3884/23 per subvencionimin e fermerëve.

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese po mundohemi t'iu paraqesim informatat shtese te cilat i keni kërkuar përmes shkresës suaj Nr.4054/2023 të datës 03.03.2023, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë se akteve komunale apo Vendimeve Nr.09-660/01-4005/23 për subvencionimin e OJQ-ve ne fushën e kulturës,rinisë dhe sportit dhe Vendimi Nr.08-320/01-3884/23 per subvencionimin e fermerëve.

Për ndarjen apo shpenzimin e mjeteve sipas Vendimit Nr.09-660/01-4005/23 për subvencionimin e OJQ-ve ne fushën e kulturës,rinisë dhe sportit, thirrjet Publike do të shpallet sipas **RREGULLORES MF - NR - 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE**, duke u bazuar në Nenet 12,13,14 dhe 15 të kësaj rregullore, ndërsa komisionet relevante do të themelohen

duke u bazuar në nenet 8, 9, ndërsa monitorimi do të bëhet duke u bazuar në nenin 23 të po kësaj rregullore.

Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Kaçanikut per vitin 2023 kodi ekonomik 21200 (subvencionet për etnitete jopublike), në kuadër të programit Kultura, Rinia dhe Sportet (850) dhe nënprogramit Shërbimet Kulturore (85028). Kjo mbështetje derivon nga fondi burimor grant qeveritar (10) Shuma totale e mbështetjes financiare 70,000.00 €.

Ndërsa realizimi i projekteve të cilat do të financohen përmes Vendimit Nr.08-320/01-3884/23 për subvencionimin e fermerëve, do të realizohen konform Ligjit dhe procedurave tjera të Prokurimit Publik për furnizim me mekanizëm bujqësorë, makina mjelëse për lopë qumështore dhe me koshere të bletëve si dhe do të ngriten komisionet përkatëse të cilat kanë për detyrë përzgjedhjen e përfitueseve sipas kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Mbështetja financiare për gjithë fermerët do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2023 kodi ekonomik 21200 (përfituesit individual), në kuadër të nënprogramit buxhetorë Bujqësia 47028 kategoria e subvencioneve dhe transfereve. Kjo mbështetje derivon nga fondi burimor grant qeveritar (10) shuma prej 78,735.00 euro dhe të hyrat vetanake komunale, fondi (21), shuma prej 21,265.00 euro, totali e mbështetjes financiare 100,000.00 €.

Me respekt;



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo / Ministry of Finance
Arhivo - Arhiva - Archive

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministry of Foreign Affairs
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministry of Internal Affairs
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministry of Culture, Youth and Sports
Ministria e Punëve të Mirë / Ministry of Labour and Social Welfare
Ministria e Urdhërimit dhe Transportit / Ministry of Order and Transport
Ministria e Urdhërimit dhe Transportit / Ministry of Order and Transport

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministry of Foreign Affairs
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministry of Internal Affairs
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministry of Culture, Youth and Sports
Ministria e Punëve të Mirë / Ministry of Labour and Social Welfare
Ministria e Urdhërimit dhe Transportit / Ministry of Order and Transport
Ministria e Urdhërimit dhe Transportit / Ministry of Order and Transport

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministry of Foreign Affairs
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministry of Internal Affairs
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministry of Culture, Youth and Sports
Ministria e Punëve të Mirë / Ministry of Labour and Social Welfare
Ministria e Urdhërimit dhe Transportit / Ministry of Order and Transport
Ministria e Urdhërimit dhe Transportit / Ministry of Order and Transport

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Besim Hazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut
	Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Kliti Shahu, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Bora Duli, Zyrtare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Kërkesë për info shtesë
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Hazi,

I nderuari Kryesues z. Murseli

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendim Nr. 09-660/01-4005/23 për subvencionimin e OJQ-ve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Vendim Nr. 08-320/01-3884/23 për subvencionimin e fermerëve

Të miratuara më datë 27.02.2023

I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.03.2023

I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 02.03.2023

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit përmbajtësor të akteve të mësipërme të Komunës së Kaçanikut, jep konstatime bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

1. Komuna e Kaçanikut, me anë të akteve administrative që janë subjekt i shqyrtimit, synon ndajen e mjeteve financiare për subvencionimin e OJQ-ve dhe fermerëve.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, një tregues i rëndësishëm për të konstatuar ligjshmërinë e aktit komunal është ndarja buxhetore e kategorizuar në bazë të programit dhe/apo klasifikimit ekonomik. Kështu që, me nenin 1 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21, ndarja buxhetore përkufizohet si:

"...shuma maksimale e përcaktuar në një Ligj për Ndarjet Buxhetore e cila mund të vihet në dispozicion për shpenzim nga një organizatë buxhetore gjatë vitit fiskal për shpenzim në një program të caktuar ose kategori tjetër shpenzimi."

3. Në këtë kuptim, çdo shpenzim i një organizatë buxhetore duhet të ketë të evidentuar kategorinë dhe/apo programin e caktuar të shpenzimit. Si plotësim i kësaj, çdo kategori dhe/apo program i organizatave buxhetore e ka shumën maksimale në dispozicion për shpenzim, e që në esencë duhet të ketë për bazë ndarjet e përcaktuara sipas Ligjit për Buxhetin e vitit 2023.
4. Në rastin konkret, për të vlerësuar ligjshmërinë e aktit komunal, Komuna e Kaçanikut në vendimin i cili është subjekt i ligjshmërisë, ka dështuar ta specifikojë nën-programin e caktuar të shpenzimit, dhe rrjedhimisht nga ku po financohet masa e përcaktuar me vendimin administrativ komunal. Në mungesë të këtij specifikimi dhe/ose precizimi, Ministria e ka të pamundur të bëjë konstatimin nëse akti komunal është i ligjshëm ose jo.
5. Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria kërkon nga Komuna e Kaçanikut informata shtesë rreth:

5.1. Shpalljes së thirrjes publike dhe themelimit të Komisioneve relevante sipas Rregullores MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve;

5.2. Informata rreth nën-programeve buxhetore dhe burimeve të fondeve (pra, sqarimin nëse burimi derivon nga grante apo të hyra vetanake), kategorinë e shpenzimeve dhe koston totale për pagesë për realizimin e vendimeve administrativ komunale, në mënyrë që të procedohet tutje me shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit administrativ.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

*** Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkatësi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ***